



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS
OSNOVNI SUD U MITROVICU – BASIC COURT OF MITROVICA

C.nr.296/16

GJYKATA THEMELORE MITROVICË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, si gjykatë e shkallës së parë, nga Gjykatësi individual Ragip Kadriu, në çështjen juridike kontestimore të paditëses: **SI** të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Av.GR me seli në Mitrovicë, kundër të paditurës **K.T.U** dhe **Komuna** e ... baza e kontestit- pagimi i të ardhurave personale, pas mbajtjes së seancës kryesore publike në prezenc të përfaqësuesit të paditëses, të përfaqësuesit të paditësit, të përfaqësuesit të paditures së dytë, e në mungesë të paditures të parë, Gjykata me datë 12.06.2019, nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

OBLIGOHEN, të paditurit: **KTU** dhe **Komuna** e ... , që në mënyrë solidare në emer të të ardhurave personale, paditëses **SI** nga, t’ia paguaj shumën prej 3,738.00 euro, me kamatë sipas lartësisë që paguhet për një vitë në bankat afariste për mjetet e depozituara pa destinim të caktuar, duke filluar që nga data e ushtrimit të padisë dt.17.07.2013, e gjerë në pagesën defintivive të borxhit, të gjitha këto ne afatë prej 15 ditësh nga data e nxjerrjes së këtij Aktgjykimi , nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

OBLIGOHEN, të paditurat që në mënyrë solidare në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore paditësit t’ia paguajnë shumën totale 289 euro, dhe atë: për përpilimin e padisë shumën prej 104 euro, për taksën për padi shumën prej 25 euro, për përfaqësim nga i autorizuari në 1 seanc gjyqësore shumën prej 135 euro, ndërsa Gjykatës për përpilimin e Aktgjykimit shumën prej 25 euro, e paditura ka obligim që t’i përmbushë të gjitha këto në afatë prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y t i m

Paditësia **SI** nga të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Av.GR me seli në, me padinë e ushtruar, ka kërkuar nga Gjykata që në emër të të ardhurave personale, ti obligoj të paditurat **KTU** dhe **Komuna** e ..., të paguaj shumën totale prej 3,738.00 euro dhe atë me kamatë vjetore për çdo muaj, si dhe shpenzimet e procedurës.

Gjykata me datë 15.05.2017, ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor në ora 10:00 h, paditësia nuk i është përgjigjur ftesës së gjyktaës edhe pse është ftuar me rregull dhe mungesën nuk e ka arsyetuar. Andaj gjykata konform nenit 409.1 të LPK-së, padinë e paditëses e ka konsideruar të tërhjekur dhe gjykata bjen Aktvnedimin me datë 16.05.2017.

Përfaqësuesi i të autorizuarës Av.GR, me datë 22.05.2017, kërkon nga Gjykata Themelore në Mitrovicë, kthimin në gjendjen e mëparshme të çështjes në fjalë, bazuar në atë se paditësia

SI nga ..., për shkak të keqësimit të gjendjes shëndetsore i është dashur të kërkoj ndihmë mjeksore në spitalin e Mitrovicës, kjo ishte arsye pse e njëjta nuk ka pasur mundësi të marr pjesë në shqyrtimin kryesor dhe kërkon nga Gjykata që në pajtim me nenin 129 të LPK-së, të e kthej çështjen në gjendje të mëparshme.

Gjykata me datë 14.05.2019, ka caktuar seancën për shqyrtimin kryesor të çështjes në të cilën ka prezantuar i autorizuari i paditëses Av.GR sipas autorizimit me shkrim, për të paditurin e parë askush edhe pse është ftuar në kohë dhe me rregull , për të paditurën e dytë avokati Publik Komunal AM.

I autorizuari i paditëses së pari propozon që seanca të mbahet në mungesë ta paditurës së parë, gjykata bjen aktvendim që seanca të mbahet në mungesë të paditurës së parë.

Në fjalën përfundimtare i autorizuari paditëses në fjalën kryesore dhe në fjalën përfundimtare deklaroi: mbetem në tërsi pranë padisë dhe kërkesëpadis si dhe e bën precizimin e shumës së pagave në total 3,738.00 euro, duke propozuar që të paditurat t'ia paguajn të ardhurat personale paditëses duke filluar prej muajit tetor të vitit 2010 e gjer në fund të muajit qershor të vitit 2012, po ashtu i kërkon shpenzimet e procedurës dhe atë 104.00 euro përpilimi i padis, 25 euro në emër të taksës gjyqësore dhe 135 euro për pjesëmarrjen në shqyrtimin kryesor.

Përfaqësuesi i të paditurës së dytë deklaroi: e kundërshton padin dhe kërkespadinë, me arsyetimin "KTU", tani NPK "", janë plotësisht të pavarur në aspektin menagjues financiar, duke kërkuar që gjykata të sjell vendim merititor.

Gjykata konstatoi se në mes të palëve ndërgjyqëse nuk është kontestuese lartësia e pagës së paditësit në shumë prej 178 euro, për periudhën nga muaji tetor 2010 gjerë në qershor 2012, gjithsejt 21 paga.

Gjykata pas administrimit të provave, të njëjtat i shqyrtoi një nga një, bazuar në nenin 7 dhe 8 të LPK-së dhe atë: Kontrata e Punës datë 29.12.2011, marrveshja mbi pranim dorzimitin e datës 20.06.2012, Formulari mbi pranim dorëzimitin i datës 20.06.2012, Gjykata konstatoi këtë gjendje faktike:

Nuk është kontestuese fakti që te paditësia ka qenë i punësuar te e paditura e parë që nga data ... deri më datë ..., ky fakt u vërtetua nga Kontrata e Punës e datës 29.12.2011.

Gjithashtu, nuk është kontestuese fakti që e paditura e dytë Komuna e ... në bazë të pranim dorëzimit të ndërmarrjes "KTU" datë nga ndërmarrja në fjalë në koordinim me menaxhmentin e saj i është dorëzuar Komisionit ... Aksioneve me asetet e obligimet e deritanishme nga rrjedh edhe detyrimi i të paditues së dytë për pagimin e të ardhurave personale për paditësen.

Gjykata, lidhur me vendosjen sipas pikës 1 të dispozitivit Gjykata u bazuar në nenin 128, 128.1, 130, 123 të Ligjit mbi shoqëritë tregtare, nenin 3 par.3.1, 4.1, 5.2 dhe 8.2 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike si dhe nenin 10, lista 2 të Ligjit për Ndryshmin dhe Plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike.

Në rastin konkret Komuna është aksionare me 100% të aksioneve në ndërmarrjen në fjalë, e njëjta ka legjitimacion për të qenë palë e paditur sipas nenit 130 të Ligjit për Shoqërit

Tregtare, po ashtu obligimi rrjedh edhe në bazë të dispozitave tjera të cituara më lartë që flasin për organizimin, përgjegjësit dhe menagjimin e ndërmarrjeve në fjalë.

Gjykata lidhur me përlllogaritjen e kamatës, u bazua në nenin 277 par.1 të LMD-së, (viti 1978), ndërsa lartësinë e saj e caktoi mbi bazën e lartësisë së kamataës që paguhet në mjetet e afatizuara në bankat afariste për një vit pa destinim të caktuar.

Gjykata lidhur me vendosjen sipas pikës II të dispozitivit për shpenzimet e procedurës, u bazua në nenin 449, 453 dhe 452 par.2 të LPK-së, ndërsa lidhur me vendosjen mbi shpenzimet gjyqësore, u bazua nën nenin 10 par.12, në lidhje me nenin 10.1 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Takave Gjyqësore të KGJK-së nr. 2008/2 dhe përshtatshmerit vendosi që këto shpenzime t'i bartin të paditurit sikurse shpenzimet procedural.

Gjykata i obligoi në mënyrë solidare të paditurat duke u mbështetur në faktin se paditësi marrëdhënien e punës e ka themeluar te e paditura e parë, ndërsa e paditura e dytë me aktin e privatizimit të ndërmarrjes ka kaluar në administrim te e paditura e dytë dhe ka pranuar të gjitha asetet dhe obligimet.

Gjykata, Aktgjykimin e mbështeti në nenin 143 par.1 të LPK-së

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
C.nr.296/2016, dt.12.06.2019

GJYQTARI
Ragip Kadriu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi lejohet ankesa në afatin prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së aktgjykimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmes kësaj Gjykate.